

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Naim Frashëri dhe vendi i tij në letërsinë shqipe

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

Valbona Thaqi

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Naim Frashëri dhe vendi i tij në letërsinë shqipe

Komisioni:

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

Valbona Thaqi

Gjakovë, 2018

PASQYRA E LËNDËS

1. Hyrje.....	4
2. Objekti dhe motivimi i temës.....	4
3. Metodologjia dhe metodat e punes.....	5
4. Baza teorike e punimit dhe synimi i temes.....	5
KREU I: Jeta dhe vepra e Naim Frashërit.....	6
1.1 Motivet që trajton Naim Frashëri në veprat e tij.....	6
1.2 Naim Frashëri atdhetar.....	8
1.3 Bagëti e bujqësia.....	12
1.4 Isteri e Skënderbeut.....	14
1.5 Naim Frashëri dhe romantizmi shqiptar.....	17
KREU II: Naim Frashëri bilbil i fjalës shqipe.....	19
2.1 Naim Frashëri dhe fjala shqipe.....	19
2.2 Ndikimi i bektashizmit në formimin e Naim Frashërit.....	20
KREU III: Rrafshi gjuhësor dhe rrafshi letrar te Naim Frashëri.....	25
3.1 Lirika e Naim Frashërit.....	25
3.2 Ligjërimi poetik i Naim Frashërit.....	27
3.3 Leksiku i gjuhës shqipe në veprat e Naim Frashërit.....	29
Përfundimet.....	30
Bibliografia.....	34

HYRJE

1. Objekti dhe motivimi i temës

Naim Frashëri si poeti u bë i pavdekshëm në mesin e shqiptarëve që kur ishte gjallë, prandaj që në fillimet e veta letrare, veprat e tij zgjuan edhe interesimin e studiuesve të tonë. Naimi Frashëri e mitizon vetëdijshëm apo pavetëdijshëm jetën e vet, sepse kohën më të vrullshme të krijimtarisë në shqip e ka në Stamboll, atje edhe vdes, duke lënë shumë pak shënime biografike për veten e tij.

Naim Frashëri nuk është vetëm poet shekullor i shqipes, por është poeti ynë kombëtar. Rëndësia e veprës së tij, kalon caqet e poetit nacional e të mendimtarit të një epoke, duke marrë vlerën e predikuesit dhe të apostullit kombëtar dhe të edukatorit të kombit. Naim Frashëri njihet sot në letërsinë shqipe për trashëgiminë, që la si në letërsinë dhe në kulturën shqiptare. Ndaj ai si personalitet i letërsisë shqipe mund t'i numërojmë shumë cilësi dhe vlera si: frymëzimi i zjarrtë lirik, mitizimi i fuqishëm atdhetar, mësimi moral, fetar e qytetërues, kultura e lartë e gjuhës shqipe dhe e shkrimit shqip. Si të gjitha shkrimtarët e mëdhenj kombëtar, Naim Frashëri i përket kohës së vet e i përket edhe kohës sonë.

2. Metodologjia dhe metodat e punës

Për të realizuar këtë temë jemi ndalur në disa metoda, por si fillim po përmendim metodën biografike dhe atë sociologjike. Metoda e parë na ndihmon, që përmes të dhënave të jetës së autorit dhe formimit të tij, të zbulojmë se pse ka shkruar kaq shumë për gjuhën, për atdheun, për letërsinë, për kulturën dhe për Shqipërinë. Ndërsa metoda sociologjike na bën të ditur se përmes të dhënave dhe faktorëve historikë, kulturorë dhe social e kanë çuar Naim Frashërin në formimin e veprave të tij, që kanë lënë gjurmë në letërsinë shqipe, siç është poema e njohur për të gjithë: “Bagëti e bujqësi”, “Bukurija”, “Qerbelaja” apo “Istoria e Skëndërbeut”. Duke përdorur herë njëjën dhe herë tjetrën kemi arritur në përfundimet e kësaj teme diplome.

3. Baza teorike e punimit

Si bazë kryesore për të realizuar këtë temë kemi shfrytëzuar veprat e Naim Frashërit, por edhe duke e gërshetuar me literaturë të bollshme shkencore. Monografitë, studimet apo referimet janë jo të pakta. Si literaturë teorike jemi mbështetur në studimet e romantizmit të Rexhep Qosjes dhe në revistën *Studime filologjike*, nr. 3-4, numër i posaçëm i botuar vetëm në kujtim të këtij autori.

4. Synimi i temës

Synimi ynë me këtë temë është të kujtojmë edhe njëherë vendin dhe rëndësinë që emri dhe vepra Naim Frashërit zënë në letërsinë shqipe. Vënia në dukje se poeti ynë kombëtar zë vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe dhe në historinë e letërsisë. Ky autor është njëri nga njerëzit e parë të rinj, modern, që historinë shqiptare, i cili shikon dhe sheh përtej kohës së vet. Ai ishte i vetëdijshëm se popullit i tij gjendej para ndryshimesh të mëdha historike, shoqërore e kulturore dhe ai përpiqej që ta aftësonte për kryerjen dhe pranimin e atyre ndryshimeve. Synim tjetër në këtë temë është edhe fakti se Naim Frashëri ishte dhe mbetet intelektual dhe krijues i parë shqiptar, i cili e ka të qartë se çështjet e mëdha kombëtare, që shtronte koha, nuk mund të zgjidheshin si duhet me njeriun e vjetër, patriarkal, të paarsimuar, të paditur apo që për çdo gjë beson në bestytini, por me njeriun e ditur dhe shpirtërisht të ngritur. Krijimit të vlerave që do të ndikojë në ndërtimin e këtij njeriu ai do t'ia kushtojë veprën poetike, veprën morale-filozofike dhe librat shkollorë.

KREU I: Jeta dhe vepra e Naim Frashërit

1.1 Motivet që trajton Naim Frashëri në veprat e tij

Naim Frashëri është krijues me dhunti të shumëllojshme dhe me kërkime të gjëra në letërsinë shqipe të romantizmit shqiptar. Vepra e tij letrare dallohet prej pasurisë ideore dhe tematike, ku dallohet për njohuri të gjëra letrare, filozofike dhe shkencore dhe që e dëshmon në veprat e fushave të ndryshme krijuese. Lidhjet e poezisë së Naim Frashërit me poezinë popullore dhe motivet, që ai huazoi nga gurra popullore është jo e pa qëllimshme nga autori. Por këto motive që Naimi trajtoi janë të kushtëzuara prej dhuntisë së tij natyrore, por edhe prej kushteve shoqërore në të cilat, lindet dhe ndërtohet mendërisht një autor, e në rastin në fjalë Naim Frashëri. Ndër veçantitë stilistike të poezisë së Naim Frashërit hyn edhe përdorimi i shpeshtë i shpirtëzimeve dhe i njerëzimeve. Mund të vërehet se njerëzimet dhe shpirtëzimet e tij, shpesh me prejardhje folklorike dhe mitologjike.

Dielli, hëna, yjet, nata, mëngjesi, fushat, zogu, lulet etj., në poezinë e tij herë përdoren si metafora apo simbole e herë njerëzohen apo shpirtëzohen porsë në mitologjinë, përkatësisht si në poezinë popullore.

Me vlerat që ka krijuar në poezinë e tij, me idetë dhe me parimet që ka mbrojtur në shkrimet e tij morale-filozofike dhe me prirjet që ka shprehur në gjuhën e tij. Naim Frashëri është bërë ndërtuesi i sistemit të parimeve, të mendimeve dhe të ndjenjave, që në historinë e mendimit politik shqiptar, është quajtur shqiptarizëm. Në qoftë se ne sot mund të themi se kombi shqiptar është një komb modern, me vetëdije kombëtare të ndërtuar jo mbi fenë, po mbi historinë, mbi gjuhën dhe mbi kulturën si përbërës të vetëqenies, mbi të cilët janë ndërtuar kombet moderne evropiane, atëherë mund të besohet se njëri prej ndërtuesve kryesorë të këtij sistemi është pikërisht Naim Frashëri.

Por kjo nuk është e gjithë ajo që Naim Frashëri ka bërë për popullin e vet. Ndikimet e tij në letërsinë, në gjuhën, në arsimin shqiptar, e, përmes tyre, në krijimin e vetëdijes kombëtare, nuk janë të gjitha ndikimet me të cilat ai e ka çuar përpara gjendjen shpirtërore të popullit shqiptar. Është edhe një ndikim

tjetër i rëndësishëm i tij: është ndikimi i tij moral dhe humanist në jetën e popullit, që mund të quhet posaçërisht i përshtatshëm në këtë kohë kur përjetojmë krizë shpirtërore dhe morale¹.

Motivet që e përgjithësojnë veprën e Naimit janë të karakterit atdhedashës, edukativ, moral, filozofik dhe fetar².

Naimi Frashëri me veprën e vet letrare, me një pjesë të saj u shndërrua edhe në mësues edhe edukator, në mësonjë të historisë dhe gjeografisë dhe i të gjitha dijeve për të cilat kishte nevojë shqiptari i pa shkollë dhe pa liri³.

Për të dhënë një gjykim të saktë për krijimtarinë e Naim Frashërit është e nevojshme të sillen parasysh kushtet historike në të cilat jetoi, gjendja e Shqipërisë dhe e Turqisë së asaj kohe, ambient fshatar bektashian, ku kaloi fëmijërinë dhe rininë e tij. Në Rilindjen Kombëtare dhe sidomos me Naim Frashërin, letërsia jonë merr për herë të parë karakter dhe shtrirje të plotë kombëtare, si shprehëse besnike e aspiratave të çlirimit dhe përparimit⁴.

Idealet e Naimit në thelb dhe në tërësinë e tyre, janë ideale përparimtare demokratike, që përshkohen nga një humanizëm i fuqishëm. Ndër motivet kryesore patriotike të trajtuara nga Naim Frashëri në krijimet e tij mund të përmendim: dashurinë dhe mallin për atdheun, krenarinë për të kaluarën historike të popullit, dashurinë për gjuhën, urrejtjen për armiqtë, përbuzjen për tradhëtarët etj. Ndjenjat dhe mendimet patriotike të Naimit janë të pastra dhe të zjarrta. Ai mburret për të kaluarën e lavdishme të atdheut, ka besim në forcat e popullit dhe shpresa të ndritura për të ardhmen, hymnizon natyrën e maleve shqiptare dhe digjet nga malli për vendlindjen, godet armiqtë dhe stigmatizon tradhëtinë, i këndon trimërisë e bashkimit dhe çdo gjë shqiptare i ngjanë e bukur dhe e madhërishtme. Naimi i dha vend të dukshëm trajtimit të temës të së kaluarës historike, duke u nisur prej tezës të së prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve dhe duke u përpjekur sa herë i vjen rasti të përmendë lashtësinë e kombit dhe njerëzit e shquar që kanë dalë nga gjiri i tij.

¹ Rexhep Qosja, *Naim Frashëri dhe gjendja shpirtërore e popullit shqiptar sot*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 6.

² Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, f. 4.

³ Ali Aliu, *Magjia e fjalës*, f. 24.

⁴ Naim Frashëri, *Ëndërrime*, f.58-59.

Në vjershën e gjatë moralizuesen “Parajsa” dhe prej shumë krijimeve me temë patriotike, Naimi nguli këmbë në nevojën e bashkimit i nisur nga mendimi se gjithë shqiptarët janë vëllezër⁵.

Naimi i këndon edhe gjuhës shqipe, ai u përpoq t’ua bënte të dashur të gjithëve gjuhën e tyre. Një tjetër element, që Naimi e përdori për të shtuar atdhedashurinë dhe e ngriti në lartësinë e idealit të bukurisë është edhe natyra shqiptare, të cilës ai me ndjeshmëri të hollë poetike i dha ëmbëlsinë dhe butësinë, harenë etj. Një tjetër motiv me rëndësi me temën patriotike të lirikës së Naimit është edhe denoncimi i tradhëtisë si dhe krimet më të rënda, që mund të kryejë njeriu në jetë. Për të tradhëtarët kanë qenë njerëzit më të pështirë⁶.

Nuk janë të rralla edhe vjershat lirike me motive shoqërore e filozofike. Ndër to zë vend me rëndësi cikli i vjershave me titullin e përbashkët “Bukuria”, që janë të vetmet krijime të poetit në shqip kushtuar dashurisë⁷.

Naimi ka trajtuar problemin e varfërisë të pabarazisë shoqërore, duke u përpjekur të ngjallë keqardhje për të varfërit me shpresë se ata që kanë do ta vënë dorën në zemër, do të mendojnë për “vëllezërit” e tyre të varfër dhe do t’u japin lëmoshë.

“Su vjen fare për të qarë,

vallë për varfërinë?” (varfërija)⁸.

1.2 Naim Frashëri atdhetar

Naim Frashëri ka jetuar dhe ka krijuar në një kohë kur vetëdija kombëtare shqiptare ishte në ndërtim e sipër dhe, pikërisht për këtë arsye, ishte e lëvizshme te grupe të ndryshme të popullsisë dhe në krahina të ndryshme të vendit⁹.

Fryma atdhetare në të cilën u rrit dhe u formua poeti ndikoi edhe në veprën e tij. Këtë mund ta vërejmë qoftë edhe në vjershat e tij për fëmijë. Naimi tërë jetën e tij i’a kushtoi atdheut, thirrjes për “zgjim”, thirrjes për arsimim.

⁵ Po aty, f. 62-63.

⁶ Po aty, f. 64-66.

⁷ Po aty, f. 71.

⁸ Naim Frashëri, *Ëndërrime*, f. 72-73-74.

⁹ Rexhep Qosja, *Naim Frashëri dhe gjendja shpirtërore e popullit shqiptar sot*, në revistën: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 5-6.

Kjo thirrje e tij bëri jehonë sepse ishte koha kur shumica e popullsisë nuk dinte shkrim-lexim dhe sipas tij lufta më e madhe bëhet me penë.

*“Ajo ish koh’ e zjartë,
Dhe kish mundime tepër,
po sot pëndë dhe kartë,
na duhet, nukë tjetër*

* * *

*Të shkruajmë gjuhën tënë,
kombnë t’a ndritojmë,
gjithë ç’është’ e çka’ qënë
nga dalëzë t’a mësojmë”¹⁰.*

Patriotizmi në qënien e tij e shtynë të bëjë krijime, që edhe sot e kësaj dite të jenë shtysë e idealeve të larta. Formimi i tij intelektual dhe atdhedashuria nuk e lejonte Naimin të rrinte i heshtur dhe të qëndronte duarkryq, duke parë atdheun e tij të katandisur qoftë nga jo arsimimi dhe nga traktatet endryshme që i’a cenonin Shqipërisë trojet dhe lirinë.

*“Kushdo që është sot burrë,
dhe Shqipëtar i vërtetë,
emëri s’i shuhet kurrë,
dhe nderi i rron për jetë*

* * *

*sjemi Grekër as Bullgarë,
as gjë tjetër nukë jemi,
Jemi vetëm Shqipëtarë,*

¹⁰ Naim Frashëri, *Lulet e verës*, poezia, Gjuha jonë, f. 70.

*Një kët' emër nder' e kemi"*¹¹.

Përmes thurjes së këtyre vargjeve synohet nxitja e burrave të vendit të vdesin me nder, sepse emri i tyre do të mbesë histori e përmendur ndër breza. Naimi dëshironte ta ruante kombin nga asimilimi dhe propaganda e pushtuesit. Sipas tij të qënit shqiptar dhe të punuarit për vendin mjafton për t'u krenuar. Qëllimi i tij është të rritë krenarinë kombëtare, ta bëjë atdheun të dashur duke i'a përshkruar me ngjyrat më të bukura natyrën e Shqipërisë. Në mesin e armiqve grekë, Naimi fut edhe Turqinë si armik i kombit, mirëpo nëse i hedhim një vështrim vargjeve tek poezia "Korça" shohim:

*"Edhe Sulltani të mirë,
Mbretit t'madh q'e kemi atë,
dhe ka për neve mëshirë,
E përpiqet dit' e natë.
Dhe qëllimet ja mbaroftë!
Me nder për mi front e lëntë!
dhe gjithnjë e gëzoftë!"*

Ç'do lëvizje që bëhet për të mirën e atdheut ka penguesit e saj, tradhëtarët. Naimi nuk e anashkaloi këtë veti negative, duke u'a bërë me dije që në çdo mes ka të tillë.

*"Shokë! Kemi në mest tënë,
shum' armiq' e tradhëtorë!"*¹².

Ai shpreh urrejtje të madhe ndaj tyre duke i mallkuar ata që e harruan mëmëdheun, nuk e njohin më të vërtetën dhe uthullën e pandehin mjaltë! Atdhedashuria e Naimit dhe vepra e tij qenë shtysë edhe për shkrimtarët e tjerë si p.sh për Gjergj Fishtën, ku në veprën e tij "Lahuta e malcis" thotë:

*"Naim Frashëri i ra Qitapit,
Mos me lshu Shqypnin për t'gjall!"*¹³.

¹¹ Naim Frashëri, *Lulet e verës*, poezia: Korça.

¹² Naim Frashëri, *Lulet e verës*, poezia: Tradhëtorët.

¹³ Gjergj Fishta, *Lahuta e malcis*, Kang e trembedhetet.

Tematikë atdhetare hasim edhe tek poema “Qerbelaja”. Këtu rrëfëhet një ngjarje që nuk njih kohë as vend, është mësim për të shtypurit se si duhet vepruar, kur është fjala për t’i mbrojtur të drejtat e tyre. Naim Frashëri thërret besimtarët shqiptarë që të përkujtojnë “Qerbelanë” dhe ta mbajnë gjallë këtë tragjedi të shenjtë.

Naim Frashëri e përfundon poemën në formë lutjeje dhe i shpreh thellë ndjenjat e tij patriotike, duke nxitur bashkombësit që ta shpëtojnë Shqipërinë, për t’i sjell shqiptarët në udhë të mbarë, për nderin e kombit, për mëmëdhenë.

*“Fali, fali Shqipërisë,
gjithë ç’ke të mirësisë”¹⁴.*

Vlerë artistike më të dukshme se disa prej vjershave atdhetare të Naim Frashërit ka vjersha e njohur “Shkëndij’ e diellit ndaj manushaqesë” e botuar në përmbledhjen “Parajsa dhe fjala fluturake”. Kjo është njëra prej vjershave të rralla alegorike të Naim Frashërit dhe vjersha e tij e vetme atdhetare alegorike e botuar më 1885 në revistën “Dituria”.

Në këtë mënyrë Naimi përdori gjuhën alegorike për të shprehur disa prej ideve të tij lirishtetërore e çlirimtare mbi gjendjen dhe ardhmërinë e Shqipërisë. Ai do të përdorë simbole siç janë: manushaqja, lulja, dielli, parasja etj. Manushaqja do të jetë Shqipëria, kurse dielli do të jetë Lëvizja Kombëtare¹⁵.

*“Ish Parajsë Shqipëria,
se ishte gjallë mirësia”¹⁶.*

Në këto vargje Shqipëria krahasohet me parajsën, gjendja e saj në kohët e shkuara e cila ishte e begatë si nga ana ekonomike ashtu edhe nga ana shoqërore dhe e tërë kjo në bazë të mirësisë.

¹⁴ Naim Frashëri, *Vepra 4*, Kënga. XXV, Rilindja, Prishtinë, f. 288.

¹⁵ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, f. 213.

¹⁶ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Parajsa, Rilindja, Prishtinë, f. 102.

1. 3 Bagëti e bujqësia

Poema *Bagëti dhe bujqësia* është vepra e parë poetike e Naim Frashërit e shkruar shqip, madje për shumë studiues edhe kryevepra e tij poetike, sepse krijon një njësi arti¹⁷.

Vepër me një poetikë të hapur: “Bagëti e bujqësija” shquhet nga larmia e trajtave dhe e rrafsheve ligjërimore, që ndërthuren brenda një stili lirik të shpenguar. Rrafshi përsiatës e bën atë një poezi të mendimit, rrafshi i përshkrimit e bën atë një poezi të peizazhit, kurse rrafshi tregimtar e bën atë një poezi të narracionit lirik, ashtu si të folurit përmes monologut e dialogut e bën atë një poezi të ligjërimit monologjik e dialogjik¹⁸.

Në këtë vepër janë kurorëzuar disa nga vlerat më të mëdha poetike të këtij autori, po para së gjithash janë shfaqur shenjat themelore të artit të tij poetik ku përgjithësisht mund të përmendim: në sistemin e vargënimit, tetërrokëshi i dyzuar në një gjashtëmbëdhjetërrokësh, që si tetërrokësh do të bëhet më vonë zotërues në veprën e tij poetike; gjuha e kulluar poetike shqipe e mbështetur në fjalor e figurë popullore; vogëlsimi, si figurë që ngrit kuptimin e afërsisë e të dashurisë me objektin e këngës; mrekullimi me natyrën e vendin, si karakterizim i artit poetik romantik; dhe së fundi një thurje poetike autentike, që në sistemin e përgjithshëm të kuptimit të veprës ngrit jetën e shqiptarëve, një etnos dhe etnos të tyre¹⁹.

Konceptimi i figurës në imazhin poetik të Naimit mund të ndiqet nëse nisemi nga dy veçori të poezisë së tij:

- Së pari, në mekanizimin e ndërtimit poetik të Naimi shpesh duket sikur prishen kufitë midis poezisë dhe prozës. Kjo, sepse, çdo dukuri që shfaqet në poezitë e tij është konceptuar si qenie e gjallë, pra, si personazh që vepron, që ka botën e tij emocionale, që vuan apo gëzon.

¹⁷ Naim Frashëri, *Bagëti e bujqësija*, Bukuresht, 1886.

¹⁸ Jorgo Bullo, *Naim Frashëri dhe zhvillimi tipologjik i poezisë shqipe*, në revistën: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 22.

¹⁹ Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 144.

- Së dyti, çka vjen si rrjedhim i së parës, personifikimi dhe nënshtresat metaforike qëndrojnë në themel të konceptimit të figurave. Personifikimi s'ka për qëllim paraqitjen pikturale të natyrës, me të cilën poeti është i shkrirë plotësisht, por ai emocionalizon gjithësinë, e identifikon me botën shpirtërore të njerëzve. Në këtë proces humanizmi të natyrës lind dinamika e figurës, e shprehjes figurative, lindin befasitë, kundërthëniet, thellësia e mendimeve dhe e meditimeve të poetit. Pikërisht mbi bazën e këtyre dy tipareve të poezisë së Naimit, mund të dallojmë në të një figurë vepruese, mund të hetojmë se si, nëpërmjet vetë figurave, lëviz mendimi poetik, lëviz bota emocionale dhe mendore e poetit. Këtë lëvizje mund ta ndjekim, duke i parë figurat naimiane në disa drejtime:

Është në vetë specifikën e gjinisë lirike raporti i veçantë që krijohet midis poetit dhe figurës. Formësimi figurative kalon nëpër dy plane:

- Në planin e parë figura ka të bëjë jo aq me arsyen se sa me përfytyrimin dhe,
- Në planin e dytë, figura ka të bëjë me qëndrimin e autorit ndaj botës, përmes një perceptimi krejtësisht individual.

Shpesh Naimi e perception figurën si krijesë të veçantë, ajo nuk shpreh thjesht një fakt, por reagimin e brendshëm ndaj diçkaje që shkrin në vetvete konkretin me abstrakten, duke mbetur shpesh me një vision disi të pakapshëm. Edhe kur i këndon vashës, figura e saj konceptohet si person real, por si diçka e pakapshme, abstrakte, një lloj përfytyrimi për shembull, bukuria, dashuria etj. Në të gjitha figurat e Naimit ka një dominante themelore, për shembull, burim jete, burim dashurie, pikërisht sepse ato s'janë figura thjesht të faktit, por të lëvizjes së mendimit²⁰.

²⁰ Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 217-218.

1. 4 Istori e Skënderbeut

Poeti në këtë poemë përmbushi kërkesën më të madhe të Rilindjes, që ta paraqesë të plotë heroin kombëtar. Ai i kthehet kësaj periudhe për ta dëshmuar atë kohë të artë dhe për t'u bërë jehonë ngjarjeve të kohës, për të ngjallur vetëdijen kombëtare, për t'i mobilizuar shpirtërisht për një luftë kundër Turqisë. Naim Frashëri e nis poemën, duke e ftuar ëngjullin e diturisë t'ia përkujtojë të kaluarën historike dhe trimat e atëhershëm si Pirron dhe Aleksandrin e Madh;

“Këndo, ëngjëll urtësinë,

Edhe gjithë mirësitë,

Skënderben, e, trimërinë,

Q'i dha Shqipërisë dritë” ... (Skënderbeu)²¹.

Në qendër të poemës është figura e Skënderbeut, për Naimin Skënderbeu është personifikimi i të gjitha vlerave: trimërisë, i urtësisë, i bukurisë fizike dhe morale. Në poemë gjejmë skënderbeun si një udhëheqës me aftësi të rralla, që diti t'i bashkonte të gjithë shqiptarët rreth idealit të madh të lirisë.

Poemën “Istori e Skënderbeut” Naim Frashëri e shkruan në fund të krijimtarisë dhe, gati, në fund të jetës. Megjithëse e boton vetëm dy vjet përpara vdekjes, më 1898, mendohet se ai këtë vepër do ta ketë shkruar disa vjet përpara se ta botonte dhe, sipas të gjitha gjasave, përpara vitit 1895, kur ende ishte në gjendje të shkruantë, sado dihet se, edhe në këtë kohë, e kishin rënduar një sërë sëmundjesh, duke i'a vështirësuar, ashtu, jetën, në përgjithësi dhe duke i'a kufizuar mundësitë krijuese.

Poema “Istori e Skënderbeut” është e paramenduar si një vepër jetëshkrimore historike, e shkruar në vargje, domethënë si një vepër që do të kishte, njëkohësisht, edhe histori, edhe poemë epike, me të cilën do të plotësohej shpraztia e madhe që në atë kohë zotëronte në

²¹ Naim Frashëri, Vepra.

përvetësimin sa dituror aq edhe emocional të historisë kombëtare të shekullit XV dhe të figurës së saj të madhe, të Skënderbeut²².

“Istorijs e Skënderbeut” përfaqëson në të cilën përmbliidhen dhe përgjithësohen si prirja historike dhe poetike e autorit, ashtu edhe prirja epike historike e romantizmit tonë, posaçërisht e forcuar nga fundi i shekullit XIX.

Ajo është edhe histori- sikundër i thotë titulli- por edhe poemë epike- sikundër e thotë trajta e saj. Ajo është vepër në të cilën përshkohen historia dhe poezia- herë në dëm të historisë e herë në dëm të poezisë.

“Istorijs e Skënderbeut është e shkruar në tetërokësh, kryesisht në tetërokësh popullor. Kjo poemë përbëhet prej, gjithsejt njëzet e dy këngësh. Ngjarjet dhe luftërat këndohen njëra pas tjetrës domethënë në kronologji.

Kështu, në vijimësinë kohore nëpër kapituj të veçantë Naim Frashëri këndon:

-Për të shkuarën e lavdishme të shqiptarëve, për ardhjen e lajmëtarëve turq që t’i ofrojnë Gjon Kastriotit paqja e Sulltan Muratit dhe, si dëshmi të ofertës së pranuar, ia kërkojnë djemtë peng (I);

- Për këshillimin e krerëve shqiptarë në lidhje me kushtin e Sulltanit dhe për shkuarjen e djemve të Gjon Kastriotit peng në Turqi (II);

-Për rritjen e Skënderbeut në Adrianopojë dhe për dyluftimet e tij me tatarin e me dy persët (III); -Për vdekjen e prindërve të Skënderbeut;

-Për helmimin e tre vëllezërve të tij nga shërbëtorët e Sulltanit dhe për mallin, që e pushton për atdheun (IV);

-Për takimin e Skënderbeut me hijen e të atit, që e vë në dije mbi gjendjen e Shqipërisë..(V);

-Për pritjen madhështore që i bëhet Skënderbeut në Krujë (VI),

²² Rexhep Qosja, *Historia e letësisë shqipe, Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, f .237-238.

Për fjalimin që Skënderbeu mban në Krujë..(VI); për shkuarjen e Skënderbeut te Varna, me qëllim që të ndihmojë mbretin Vlladislla dhe mbretin Gjon Huniadi në luftën kundër ushtrisë turke në krye me Firuz Pashën (VIII);

-Për luftën kundër ushtrisë venedikase..(IX);

-Për disfatën e sultan Muratit gjatë rrethimit të Krujës (XI);

-Për lidhjen e armëpushimit ndërmjet Turqisë dhe të Shqipërisë, për fjalimin testamentary, që mban Skënderbeu para vdekjes dhe për vdekjen e tij (XXI).

Në mesin e poemës, si këngë të XII, Naim Frashëri vë këngën mbi ngritjen e ëndërruar të Skënderbeut në qiell dhe për martesën e tij, në moshën dyzetvjeçare, në të cilën paraqet pikëpamjet e tij etike, filozofike dhe, pak a shumë, estetike.

“Istorija e Skënderbeut mund të quhet edhe histori e vjershëruar e Skënderbeut dhe e luftërave kundërturke të shqiptarëve në krye me të. Në të poezia, kryesisht qëndron në vargun, kurse historia në të dhënat, në ngjarjet dhe në vijimësinë kohore sipas të cilës paraqiten ato²³.

²³ Po aty, f.240,241,242,243.

1. 5 Naim Frashëri dhe romantizmi shqiptar

Naimi Frashëri është quajtur më parë një shkrimtar romantik ballkanik (E. Çabej), duke pasur parasysh karakterin e krijimtarisë së tij, e cila duke ngjallur një kulturë e një letërsi kombëtare me temën dhe karakterin e saj, kërkon të ringjallë një komb të tërë. Përkufizimi i tillë i Naimit si krijues ushqehet me idenë mbi kulturën shqiptare midis Lindjes dhe Perëndimit²⁴.

Letërsia shqipe e traditës, pa përpunuar ndonjë platformë estetike, i dha shtat romantizmit, rrymës më të qartë e më të qëndrueshme të historisë së saj. Brenda këtij zhvillimi thuajse gjithëpërfshirës, bie në sy pa shumë vështirësi se hapësirat, ku mori jetë romantizmi shqiptar ishin mjaft të shpërndara: poetët arbëreshë, siç dihet, jetuan e punuan në vise të Italisë së Rumanisë, ndërsa Fishta, Mjeda e të tjerë në Gropë të Shkodrës. Më anë tjetër, ligjërimi poetik i veprave tona të romantizimit u krijua me një shqipe, e cila, megjithatë, ndryshonte në veçoritë e saj fonetike, leksikore dhe gramatikore. Naimi, e të tjerë romantikë rilindës, duke ruajtur natyrisht tiparet e shqipes së vendlindjes së tyre, krijuan me një toskërishte përgjithësisht të qartë për të gjithë shqiptarët e arsimuar²⁵.

Ky krijues e njeri i letrave kishte një kulturë të thellë antike që është perëndimore; në anën tjetër ai njohu letërsinë e lindjes, sidomos letërsinë perse. Duhet të kihet parasysh që Naim Frashëri në fillim shkroi vepra të plota letrare në persisht “Ëndërrime”, në greqisht “Dashuria” dhe “Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve” dhe në turqisht “Katër stinët”. Kthesa e tij krijuese dhe zgjimi i tij bëhet atëherë, ku gjuhë të shkrimit të vet e bën shqipen, si dhe temat dominante i bën tema personale dhe tema kombëtare²⁶.

Naim Frashëri është reformator shpirtëror i botës shqiptare, reformator i gjuhës shqipe. Ai e ndjeu qartë aspiratën historike, e ndjeu nevojën e shpirtit dhe mendjes kombëtare, e hetoi zjarrin gjysëm të ndezur të shtresuar thellë gjatë shekujve dhe, përmes veprës së tij e artikuloi

²⁴ Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Prishtinë, 2003, f. 175.

²⁵ Ali Xhiku, *Naim Frashëri dhe shkollat e romantizmit shqiptar*, në revistën: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 16.

²⁶ Po aty, f.24.

si askush më parë. Përmes veprës së vet poetike Naim Frashëri ka ushtruar ndikim në nxitjen dhe formimin e ndërgjegjjes kombëtare shqiptare për më shumë se një shekull²⁷.

²⁷ Ali Aliu, Magjia e fjalës, f. 23-24.

KREU II: Naim Frashëri bilbil i fjalës shqipe

2.1 Naim Frashëri dhe fjala shqipe

Naim Frashëri gjenialisht e ndjeu mundësinë e brendshme të gjuhës shqipe dhe realizoi kodin unik poetik të shqipes. Ai provoi dhe i dëshmoi mundësitë e tij të pashtershme për të artikuluar mendime dhe ndjenja nga më abstraktet dhe me të nuancat përmes veprës së vet poetike. Ai dhe vepra e tij u pranuan nga të gjithë si më i pakontestueshmi në mbarë hapësirën shqiptare më shumë se një shekull.

Për më shumë se njëqind vjet, vepra e tij rrezaton ndjenjën e dashurisë për njeriun, atdheun dhe kombin. Ajo vazhdon të përcjellë impulse në përkrahje të mirësisë dhe dashurisë mes njerëzve, të rrezatojë vlera artistike që i kanë rezistuar kohës dhe që do të vazhdojë te ushtrinë ndikim të dorës së parë mbi botën shpirtërore shqiptare. Veprat e tij si “Histori e Skënderbeut”, “Qerbelaja”, “Bagëti e bujqësi” e shumë lirika patriotike përbëjnë, sot e kësaj dite, kulmin e poezisë me tematike patriotike²⁸.

Vepra poetike e Naimit vuri bazat e letërsisë kombëtare dhe luajti një rol të dorës së parë për zgjimin e vetëdijës atdhetare të bashkëkombësit.

Ai u bë themelues i një letërsi të re më përmbajtje atdhetare e njerëzore, me forcë artistike dhe me vlera të shquara stili, duke zgjeruar jo vetëm tematikën dhe problematikën e saj, por duke i kthyer fjalës shqipe forcën e saj estetike, duke i dhënë shqipes fytyrën e një gjuhe të lëvruar të kulturës moderne të shqiptarëve. Me poemat e vjershat e tij lirike Naimi i këndoi mallit e dashurisë për atdhe, krenarisë kombëtare dhe të kaluarës së lavdishme të shqiptarëve. Por ai zbuloi edhe të fshehtat e shpirtit njerëzor, duke medituuar për jetën dhe vdekjen, bukurinë dhe dashurinë, qenien e mosqenien, Perëndinë dhe gjithësinë, në frymëzimin e poetik e fikofofik që karakterizon mendimin e tij.

²⁸ Ali Aliu, Magjia e fjalës, f.23-24.

Naimi pohoi me gjuhën e artit qenien e atdheut e të atdhetarizmit shqiptar, duke krijuar imazhin poetik të mëmëdheut që u mungonte shqiptarëve, që e kishin dhe nuk e shikonin ose nuk e ndienin se e kishin ashtu të bukur e madhështor.

Ky imazh i ftonte të ktheheshin në atdhe. Ky ishte misioni i poezisë së Naimmit, i cili u njëjtësua në vetëdijen e kombit me qiririn që digjet për njeriun dhe lirinë. Naim Frashëri themeloi stilin e mirëfilltë lirik në letrat shqipe dhe ngriti fjalën shqipe në rrafshin e poezisë e të artit të vërtetë. Duke vënë në bazë të gjuhës së poezisë gjuhën popullore, Naimi e emancipoi shprehjen poetike dhe i cliroi fjalët nga inercia e një tradite të ngurtësuar.

Me veprën e Naim Frashërit letërsia shqiptare mohoi në thelb traditën e zhvillimit të saj të varur nga ndikimi i letërsive dhe i kulturave të tjera; ajo nisi të zhvillohej në mënyrë të pavarur si letërsi e kombit shqiptar, me tiparet e veta.

Naimi Frashërit e afroji kështu letërsinë me proceset e zhvillimit shpirtëror e kombëtar të shqiptarëve dhe e bëri shprehëse të njëmendtë të ndërgjegjes së tyre morale e estetike²⁹.

2.2 Ndikimi i bektashizmit në formimin e Naim Frashërit

Duke qenë se Naimi mësimet e para i mori nga hoxha i fshatit kjo do ndikojë natyrshëm edhe në veprën dhe formimin e tij. Predikimi i tij themelor për dashurinë njerëzore, e cila në filozofinë e tij bëhet universal, e krijon konceptin themelor-mirësinë, i cili koncept përfshin dashurinë, butësinë, urtësinë dhe mëshirën. Tejpamja e tij është aktuale për botën shqiptare, edhe për prirje politike edhe për fe³⁰.

Titujt e krijimeve me tematikë fetare janë të shumta, këtu vlen të përmendet poema “Qerbelaja”.

Kjo poemë është epike e luftërave të khalifit Ali dhe të bijve të tij kundës Mavijës dhe bijve të tij për fronin e khalifatit arab. Si poema “Istori e Skënderbeut” ashtu edhe poema “Qerbelaja”

²⁹ Zymer Mehani <https://www.ikvi.at/?p=18561>.

³⁰ Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Botime të veçanta XLIX, Prishtinë, 2003, f. 173.

janë vepra mbi të kaluarën historike që më dukshëm se të gjitha shkrimet e tij të tjera në vargje, përfaqësojnë shprehjen e kërshërisë historike të Naim Frashërit³¹.

Poema “Qerbelaja” përbëhet nga 25 këngë, ku vargjet janë të renditura pa ndërprerje njëra pas tjetrës. Ai zgjodhi tetërrokëshin e këngës lirike popullore, sepse ajo që më e përhapur dhe më e afërt me lexuesin. “Qerbelaja” është një poemë e gjatë që meriton vëmendjen e studiuesve, sepse hedh dritë në shumë drejtime: ajo na ndihmon të njohim plotësisht personalitetin e autorit, botëkuptimin e tij, dhe ato parime fetare që mbrujtën shumicën e veprave të tij. Përveç kësaj, tani mund të themi se “Qerbelaja” na jep mundësinë të krahasojmë dy botë kulturore: botën kulturore që i referohet islamizmit dhe në veçanti bektashizmit, me botën kulturore që i referohet krishtërimin. “Qerbelaja” zgjeron horizontin kulturor kombëtar dhe rreh çështje që i përkasin botës kulturore-fetare mbikombëtare dhe ndërkombëtare³².

Jo shumë rrallë vërehet largimi nga ligjet strikte të Islamit dhe Kur’anit, sepse siç dihet në fenë islame është i ndaluar shenjtërimi i gjallesave madje edhe i profetëve. Naimi Frashëri si pjesëtar dhe themelues i sektit bektashi nuk i përfill këto rregulla. Në poezitë e tij shihet njëzimi i njeriut me Perëndinë. Sipas tij njeriu i mirë dhe i mëshirshëm arrin gradat e të qenurit i shenjtë.

Në qendër të besimit të tij ka Aliun, Hasanin, Hysejnin dhe Fatimen poashtu edhe tetë imamët tjerë ndër të cilët janë imamët si: Eba Myslimi, Imam Xhaferri, Abdullahu etj.

“Zot i math Eba Myslimi,

të mos ish kordh’ e atija,

nukë ngritej robëria”³³.

* * * *

“Zot’ i mirë Imam Xhaferi,

³¹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, f.238.

³² Italo Costante Fortino, *Naim Frashëri: kufij letrarë dhe pikëpamje krahasuese*, në revistën: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 26.

³³ Naim Frashëri, *Vepra 4*, Kënga XXII, Rilindja, Prishtinë, f. 245.

*shpirt math e zemrë gjeri,..*³⁴.

Naimi hyjnizon edhe natyrën si në rastin konkret:

*“Zoti është drit’ e qiellit dhe e dheut. Ngado kthehemi e tekdo shikojmë shohëmë fytyrënë’ e Zotit. Se ajy kreu gjithësinë, dhe gjithësia është’ ajy vetë”*³⁵.

Në njërën anë thuajse është thirrje për meditim mbi krijimet e Zotit e në anën tjetër barazim i Zotit me natyrën. Në qoftëse shohim ngado përreth, edhe nëse vështrojmë vetën tonë shohim Perëndinë atëherë i bie që të besojmë në vete, sepse sipas Naimit Zoti gjendet në çdo krijim të tij dhe më nuk i mbetet njëjësimit Zotit, e kjo nuk është shtyllë e feve monoteiste.

Kjo shihet tek pjesa:

“Kur desh Zot’ i vërtetë të dilte vetë në shesht kreu në jetë njerëzinë me fytyrë të tija”..³⁶.

Tek kritika e Faik Konicës “Shënim mbi metafizikën e bektashinjëve” thuhet: “Edhe pse nuk kanë as kult të dukshëm as vend për lutje, bektashinjët, megjithatë si duket kanë një tërësi parimesh mëtafizike të ndërlidhura, përmes raportesh të ngushta që formojnë një trup të doktrinës..”³⁷.

Më tej vazhdon; “Po ashtu del qartë se, bektashinjët si duket Zotin e konsiderojnë vetëm tërësi të jetës universale. Ja se ç’thotë poeti shumë i njohur N.H.F bektashi, në një vëllim të vargjeve:

“Lulet e verësë”:

“Besojmë Zotnë, ç’është’ i vërtetë,

se gjithë ç’shohim është’ ay vetë” (L.V, Besojmë f.34)

“Se ngado që ktheni sytë,

shoh atje Zot’n e vërtetë” (L.V, Jeta f.24)

³⁴ Po aty, Kënga XXIII, f.255.

³⁵ Naim Frashëri, *Vepra 6*, “Urtësija”, Rilindja, Prishtinë, f. 184.f. 184.

³⁶ Po aty, f.185.

³⁷ Faik Konica, *Kritikë Letrare 4*, f.49.

“Fuqi e Perëndisë,

Duket tekdo,

Se shpirt’ i gjithësisë,

Po është ajo” (L.V, Zëmra f.31)

“Ç’sheh, është Zot’ i vërtetë,

Ç’dëgjon është zër’ i tija,

Gjith çka e s’ka në jetë

Është vet Perëndia” (L.V, Perëndija f.66)

“Ja se ç’është panteizmi i pastër e ne jemi mjaft larg doktrinës së Kuranit”³⁸. Bektashizmi lidhet me islamin përmes një lidhjeje shumë të dobët, sepse mjafton ta njohësh veprën e Naimit dhe rregullat e shkencës islame, shohim shumë aspekte të cilat biejnë ndesh me njëra tjetrën.

Trinitetin e krijuar nga bektashinjtë e përbërë nga Aliu, Hasani, Hysejmi, Konica e lidh me trinitin e kristianizmit.

Tutje thotë: “Është e rëndësishme se si bektashinjtë e pajtojnë bektashizmin e tyre të manifestuar me këtë besim në një trinitet. Ndoshta për ta ky trinitet është vetëm manifestim i Jetës Universale”.

“Lind vera, lint ngrohtësia, lind Aliu vetë Zoti” (L.V, Dit’ e re, f.299)³⁹.

Duke marrë model nga kristianizmi, Fatimes, bijës së Profetit i m’vishen tipare të Marisë.

“O nëna jon’ e vërtetë!

³⁸ Po aty, f.52.

³⁹ Po aty, f.53.

të qofshim falë për jetë!

ç'zemërë të mirë pate!

të keqen e baltës s'atë!"⁴⁰.

Tek bektashizmi Naimi gjeti shprehjen e ciltër të dëshirës se atdheu është mbi të gjitha, është mëmë e at, është besim e fe. Jo më kot ai i'u qas kësaj "feje" me gjithë zemër. Naimi u përpoq t'u jepte shqiptarëve bektashian librin e tyre të shenjtë, libër në të cilin atdheu dhe besimi janë paralel. Nga bektashizmi nuk u ndikua vetëm Naimi, aty gjetën poetë e gojëtarë të rrallë.

⁴⁰ Naim Frashëri, *Vepra 4*, Kënga II, Rilindja, Prishtinë.

KREU III: Rrafshi gjuhësor dhe rrafshi letrar te Naim Frashëri

3.1. Lirika e Naim Frashërit

Sipas pikëpamjeve të Naim Frashërit, rrafshi gjuhësor dhe ai letrar janë në sinkroni me njëra-tjetrën. Gjuha është mjete i komunikimit ndërmjet njerëzve, sepse po të mos çmohej vetëm ashtu siç diti ta bënte Naimi, ajo do të mbetej e panjohur në etnitetin e saj dhe që gjuha është e rëndësishme në botëkuptimin e tij.

Qëndrimi i tij ndaj fjalëve të huaja në gjuhën kombëtare sikur e dëshmon bindjen se shkalla e mëvetësisë kombëtare të një populli më së miri mund të shihet e të njihet përmes shkallës së zhvillimit e të përsosjes në të cilën flet dhe shkruan ai. Gjuha e përzier me fjalë të huaja sqaron fatin e historinë, gjendjen dhe kulturën e një vendi apo të një kombi.

Si për Naimin ashtu edhe për romantikët e tjerë shqiptarë, fjalët e huaja e cenojnë, kurse fjalët e reja, me të cilat zëvendësohen ato, e ruajnë identitetin kombëtar; për të fjalët e huaja janë dëshmi e kulturës së pushtuar⁴¹.

Studiuesit e gjuhës së tij kanë vërejtur se Naim Frashëri ka krijuar një numër, pak a shumë, të madh fjalësh të reja.

Roli i tij për zhvillimin dhe pasurimin e leksikut të shqipes lejon të thuhet se Naim Frashëri është krijuar i madh në fushë të poezisë por, njëkohësisht, është krijuar i madh edhe në fushë të gjuhës shqipe. Njohja e gjuhëve të huaja në mënyrë të veçantë do ta ndihmojë Naim Frashërin në krijimin e fjalëve të reja të gjuhës diturore.

Temat e rinjë diturore që Naim Frashëri krijon vetë, përpos të tjerësh, janë edhe këta: degë për segment (në gjeometri), lëndë për materie, qark për horizont, thërmie për molekulë, tejkronjë për telegraf, rrotullues për planet, falëtoare për tempull, fortesë për kështjellë etj..

⁴¹ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, f.266-267.

Naim Frashëri është krijuesi i parë shqiptar që do të përdorë dhe do të popullarizojë fjalën “dituri” në gjuhën shqipe⁴².

Fjalët e reja që krijon Naim Frashëri me anën e parashtesave janë: mosdija, mosqenja, i pa-arësyer, i paçmuar, i padëgjuar, i pa-dukurë, i pa-fëlliqurë, i pagdhendurë, të pagoditurë, të pamësuar, të pa-ndarë, e pa-sosurë, e pa-shuar, i pa-tundur, padije, nënëmbret, përshëndosh, e të tjera.

Fjalët e reja që krijon Naim Frashëri me anën e prapashtesave janë: mbanjës, mundonjës, shkrettonjës, rrëfenjës, mburonjës, shtrigëri, foshnjëri, qytetëri, butësi, ngrehtësi, mituri, dhelpëri, paqësim, këndim, mësim, dhenje, paudhësi, robëri, kallëzim, prshim, mallëngjim, fletore, peshore, gjelbërore, bukuroshe, vogëloshë, radhos, guros, lartësonj, qetoj, poshtëronj, e të tjera.

Fjalët e reja të përbëra që krijon Naim Frashëri me përfitim fjalësh janë: burra-madhe, ditë-zi, dorë-gjati, duar-thatë, dhembje-math, faqe-zjartë, fjalë-bukur, fjalë-ëmbëlë, hark-bukur, jetë-gjatë, këmbë-qetë, kokë-thatë, lesh-bardhë, mendje-gjerë, mendje-ndritur, punë-mbarë, e të tjera⁴³.

Dëshira që çdo fjalë të huaj, madje çdo nderkombëtarizim ta zëvendësojë me një fjalë të shqipes do ta shtyjë Naim Frashërin që, përpos fjalëve të tilla që nuk do mbesin, në vend të një fjale për një kuptim të përdorë togëfjalësha.

Kështu përshembull fjalën vullkan, që nuk mund ta kalojë lehtë në shqipen, e përkthen me togfjalëshin “mal që nxjerr zjarr”.

Përpos me fjalët e reja të gjuhës diturore dhe të gjuhës poetike, zhvillimin, pasurimin dhe përsosjen e gjuhës shqipe Naim Frashëri do ta nxisë sado pak, edhe me përdorimin e disa fjalëve plaka që janë përdorur shumë kohë përpara, por që mandej janë harruar.

⁴² Po aty, f.268-269.

⁴³ Po aty, f.270-271.

Përpos një numri të madh krahinorizmash, që përdoren në vendlindjen e tij, në Dangëlli apo, madje, edhe në vise të tjera të Toskërisë, Naim Frashëri, kur e kur, do të përdorë edhe disa krahinorizma, që përdoren në vise të tjera të gjuhës shqipe.

Naim Frashëri do ta ndihmojë e ta nxisë edhe me fjalët dhe shprehjet folklorike, që kishin pasur përdorim kuptimor ose të kufizuar ose të ngurtë. Larmia në renditjen e fjalëve e të grupeve të fjalëve në fjalinë; larmia e tipave të gjymtyrëve, që përcaktojnë intonacionin e fjalisë; ndryshimet në përbërjet sintaksore të fjalisë; larmia e trajtave bisedore që përdorë në shkrime të ndryshme; frazeologjia - të gjitha këto risi të sintaksës, të krahasuara më veçoritë sintaksore të shkrimeve të shkrimtarëve të tjerë të përparshëm apo, madje, edhe të kohës së tij, do të tregojnë se si Naim Frashëri e nxit shumë zhvillimin e gjuhës shqipe⁴⁴.

3.2 Ligjërimi poetik i Naim Frashërit

Naim Frashëri dhe Millosh Gjergj Nikolla janë krijues, veprat letrare të të cilëve kanë një rëndësi të posaçme në historinë e letërsisë shqipe në përgjithësi, kurse të poezisë lirike në veçanti. Megjithëse vlera artistike e veprave të tyre nuk është, as s'mund të jetë e barabartë, për shkak se vlera artistike e njërës është më e madhe apo më e vogël se e tjetrës, vlera e tyre ka rëndësi historiko-letrare në radhë të parë për arsyen pse ndryshojnë prej njëra-tjetrës me karakteristikat e veta ideo-estetike dhe pse me këto ndryshime shënojnë periudha të ndryshme në letërsinë shqipe⁴⁵.

Krijimtaria e Naimit, dhe veçanërisht poezia e tij, shënuan një ndryshim të thellë në zhvillimin e shqipes poetike, jo thjesht në aspektin tipologjik të formave dhe të zhanreve që ajo kultivoi. Organizimi i tekstit në rrafsh leksikor e semantik dhe në rrafsh sintaksor, shmangu konfliktin ose mospërputhjen midis sistemit të strukturës individuale të tekstit dhe strukturës së gjuhës së

⁴⁴ Po aty, f.273,274,275,276.

⁴⁵ Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, vepra 1, vëllimi i parë, Insitutiti Albanologjik, Prishtinë, 2010, f. 74.

folur popullore. Me poezinë, po dhe me prozën e tij, Naimi krijoi modelin e shqipes letrare, të lëvruar në rrafshin e gjuhës dhe kulturës moderne të shqiptarëve⁴⁶.

Krijimtaria poetike e Naimit në njëfarë mënyre pajtohet me forcimin e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe një shkrimtar, me emrin e të cilit lidhet formimi i vetëdijes kombëtare të kombit, nuk mund të mos jetë aq i rëndësishëm në historinë e letërsisë dhe të kulturës së popullit të vet, qoftë edhe pavarësisht prej rëndësisë thjesht artistike të krijimtarisë së tij letrare.

Naim Frashërin e kanë çmuar lart të gjithë për shkak se për të kanë mundur të shkruajnë si për një poet, që ka shtruar bazat e letërsisë kombëtare, si për një iluminist, që i ka dhënë një kontribut shumë të çmuar ngritjes kulturore të popullit të vet, si për një pedagog, që i ka dhënë një hov të madh arsimit kombëtar, si për një mendimtar, që, le të jetë edhe në mënyrë amatore, është marrë me mendimin filozofik, dhe, në fund, si për një moralist, që, prapë, në mnëyrë amatore, është marrë me çështje etike dhe morale⁴⁷.

Përpyekja që gjatë analizës së veprës letrare të veçantë apo të tërësisë së letërsisë kombëtare të kapet totaliteti i fenomenit letrar, domosdo shpie te takimi me treshin famoz: *autori-vepra-lexuesi*, të cilin nuk mund ta përjashtojë kurrfarë trajtimi më serioz i letërsisë. Trajtimi i përbashkët i këtij treshi e jep totalitetin e letërsisë kurse forcimi apo mënjanimi i cilitdo prej tyre e bën të ngushtuar trajtimin e saj.

Në studimet tona në të shkuarën analiza është përqendruar në autorin, nga shkak i thjeshtë se është mbiçmuar ideja në veprën letrare kurse vetë shkrimtarët ishin intelektualët e parë për të mos thënë edhe figurat më të çmuara në historinë e kombit. Kështu që çfarëdo shkrimi me pretendime historike, shoqërore, po se po edhe letrare i del para problem i madh i ndarjes, i dallimit të punës së apostullit nga puna e krijuesit, problem që e hetonte që moti Çabej në shembullin e Naim Frashërit.

I njëjti problem apo i ngjashëm del edhe kur trajtohet veçanërisht funksioni shoqëror i letërsisë, kur ky funksion tenton të ngrihet në kriter të vlerës letrare, madje edhe në një vlerësim

⁴⁶ Jorgo Bullo, *Naim Frashëri dhe zhvillimi tipologjik i poezisë shqipe*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 22.

⁴⁷ Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, vepra 1, vëllimi i parë, Insitutiti Albanologjik, Prishtinë, 2010, f. 76.

retrospektiv të letërsisë dhe merret me veprat e të shkuarës. Ky problem mund të shihet më saktësisht dhe të sillet në masën e vet nëse ky përmbahet në vetë strukturën e saj të mbrendshëm i veprës letrare, i cili përmbahet në vetë strukturën e saj të brendshme dhe në kuptimin e saj të përgjithshëm⁴⁸.

Naim Frashëri është krijues, mendimi i të cilit është shtrirë në fusha të ndryshme të kulturës kombëtare, prandaj rëndësia e tij është rëndësi e të parit në shumë pikëpamje, dhe, madje, e të parit të gjithanshëm⁴⁹.

Naim Frashëri, ka shkruar libra shkollorë, didaktikë, etikë dhe fetarë, duke bërë ashtu një punë të rëndësishme arsimuese dhe të parëndësishme fetare, por edhe duke i derdhur prirjet e veta në anë të ndryshme: koha në të cilën krijonte kërkonte prej tij që të merrej me gjithçka. Përpos me poezinë lirike dhe epike, që janë format më të rëndësishme të krijimtarisë së tij, ai është marrë edhe me fjalë të urta dhe me fabula që, gjithashtu, kanë rëndësi për krijimtarinë e tij dhe për letërsinë shqipe në tërësi. Format përmes të cilave shprehet Naim Frashëri dëshmojnë se letërsia jonë në atë kohë ishte në periudhën e iluminizmit dhe të romantizmit kombëtar⁵⁰.

3.3 Leksiku i gjuhës shqipe në veprat e Naim Frashërit

Naim Frashëri ngriti vlerat e fjalës shqipe në rrafshin e gjuhës së poezisë e të artit të vërtetë, duke vënë në bazë të gjuhës së poezisë gjuhën popullore⁵¹ dhe se forca e fjalës në poemën e Naimit nuk qëndron në kuptimin e drejtpërdrejtë të saj, por në ato marrëdhënie asociative ose tek aureola emocionale që u jep atyre konteksti në të cilin përdoren⁵². Prej këtij kuptohet që studimi i ligjërit mund të përfshijë dy rrafsh: rrafshin gjuhësor dhe atë letrar. Lidhja e ngushtë e të dy rrafsheve do të ishte e frytshme kjo kërkim si dorën e gjuhëtarit, ashtu edhe

⁴⁸ Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 22-23.

⁴⁹ Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, vepra 1, vëllimi I parë, Insitutiti Albanologjik, Prishtinë, 2010, f.76.

⁵⁰ Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, vepra 1, vëllimi I parë, Insitutiti Albanologjik, Prishtinë, 2010, f. 82.

⁵¹ Jorgo Bullo, *Tipologjia e lirikës së Naimit Frashërit*, Tiranë, 1999, f. 12.

⁵² Jorgo Bullo, *Tipologjia e lirikës së Naimit Frashërit*, Tiranë, 1999, f. 108.

mendjen e dorën e studiuesit e të kritikut letrar. E kemi pohuar më parë që “ligjërimi poetik i Naimit mund të vështrohet në rrafshin gjuhësor dhe në rrafshin stilistik⁵³.

Ndër faktorët që e kushtëzojnë këtë tipologji leksiko-semantike mund të përmendim ligjërimin poetik, intuitën krijuese, kulturën dhe shijen gjuhësore, frymën e përgjithshme të epokës, gjendjen e gjuhës amtare në epokën e dhënë. Poema Bagëti e bujqëi është një tekst poetic prej katër vargjesh ku ka gjithsej 21 fjalë shënues, nga të cilat 14 emra, 5 mbiemra, 1 folje dhe 1 ndajfolje. Pra, teksti nga pikëpamja e tipologjisë leksikore, është “emëror”⁵⁴.

⁵³ Jani Thomai, *Vështrim mbi leksikun e ligjërimin poetik të Naim Frashërit*, në revistën: “Stili 97”, Shkup, 1998, f. 37.

⁵⁴ Jani Thomani, *Për një tipologji leksiko-semantike të ligjërimin naimian*, në revistën: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, tiranë, 2000, f. 54.

PËRFUNDIME:

Naim Frashëri është poeti i pavdekshëm në mesin e shqiptarëve që në gjallje të tij, prandaj që në fillimet e veta, veprat e tij zgjuan edhe interesimin e studiuesve shqiptarë. Naimi e mitizon vetëdijshëm apo pavetëdijshëm jetën e vet, sepse kohën më të vrullshme të krijimtarisë në shqip e ka në Stamboll, atje edhe vdiq, kurse për veten e tij la pak shënime biografike. Naim Frashëri është poet shekullor i gjuhës shqipe dhe poeti ynë kombëtar.

Rëndësia e tij kalon caqet e poetit nacional e të mendimtarit të një epoke, duke marrë vlerën e predikuesit dhe të apostullit kombëtar dhe të edukatorit të kombit. Naim Frashëri njihet sot në letërsinë shqipe për trashëgiminë që la si në letërsi dhe në kulturë. Ndaj ai si personalitet i letërsisë shqipe mund t'i numërojmë shumë cilësi dhe vlera si: frymëzimi i zjarrtë lirik, mitizimi i fuqishëm atdhetar, mësimi moral, fetar e qytetërues, kultura e lartë e gjuhës shqipe dhe e shkrimit shqip. Si të gjitha shkrimtarët e mëdhenjtë kombëtar, Naim Frashëri i përket kohës së vet e i përket edhe kohës sonë.

Ndërsa përse i përket metodologjisë së punimit shkencor për realizimin e kësaj teme, mund të përmendim përdorimin e herë pas hershëm të metodës biografike dhe asaj sociologjike.

Metoda e parë na ndihmon që përmes të dhënave që na jepen për autorin, të zbulojmë se pse ka shkruar kaq shumë për gjuhën, letërsinë, kulturën dhe për Shqipërinë. Ndërsa metoda sociologjike na bën të ditur se cilët faktorë historikë, kulturorë dhe social e ka çuar Naim Frashërin, në formimin e veprave të tij, që kanë lënë gjurmë në letërsinë shqipe, siç është poema e njohur për të gjithë: “Bagëti e bujqësi”, “Bukurija”, “Qerbelaja” apo “Istoria e Skëndërbeut”. Gjatë punës sonë kemi përdorur herë njerën apo tjetrën, por pa lënë këtu të përmendim edhe metodën krahasimtare.

Si bazë kryesore për të realizuar këtë teme kemi shfrytëzuar veprat e Naim Frashërit, por edhe duke e gërshetuar me literaturë të bollshme shkencore. Monografitë, studimet apo referimet janë jo të pakta, në lidhje me emrin dhe veprën krijuese të Naim Frashërit. Si literaturë teorike

jemi mbështetur në studimet e romantizmit të Rexhep Qosjes dhe në revistën *Studime filologjike*, nr. 3-4, numër i posaçëm i botuar vetëm në kujtim të këtij autori.

Synimi ynë me këtë temë është të kujtojmë edhe njëherë vendin që Naim Frashëri zë në letërsinë shqipe. Vënia në dukje se poeti ynë kombëtar zë vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe dhe në historinë e letërsisë. Ky autor është njëri nga njerëzit e parë të rinj, modern, që historinë shqiptare, i cili shikon dhe sheh përtej kohës së vet. Ai ishte i vetëdijshëm se popullit i tij gjendej para ndryshimesh të mëdha historike, shoqërore e kulturore dhe ai përpiquej që ta aftësonte për kryerjen dhe pranimin e atyre ndryshimeve. Synim tjetër në këtë temë është edhe fakti se Naim Frashëri ishte dhe mbetet intelektual dhe krijues i parë shqiptar, i cili e ka të qartë se çështjet e mëdha kombëtare, që shtronte koha, nuk mund të zgjidheshin si duhet me njeriun e vjetër, patriarkal, të paarsimuar, të paditur apo bestyt, por me njeriun e ditur dhe shpirtërisht të ngritur. Krijimit të vlerave që do të ndikojë në ndërtimin e këtij njeriu ai do t'ia kushtojë veprën poetike, veprën morale-filozofike dhe librat shkollorë.

Naim Frashëri është krijues me dhunti të shumëllojshme dhe me kërshëri të gjëra në letërsinë shqipe të romantizmit shqiptar. Vepra e tij dallohet prej pasurisë ideore dhe tematike të veprave, ku dallohet për njohuri të gjëra letrare, filozofike dhe shkencore, që dëshmon në veprat e fushave të ndryshme krijuese. Lidhjet e poezisë së Naim Frashërit më poezinë popullore dhe motivet që ai huazoi nga gurra popullore është e qëllimshme nga autori.

Por këto motive që Naimi trajtoi janë të kushtëzuara prej dhuntisë së tij natyrore, por edhe prej kushteve shoqërore në të cilat, lindet dhe ndërtohet mendërisht një autori, e në rastin në fjalë Naim Frashëri. Ndër veçantitë stilistike të poezisë së Naim Frashërit hyn edhe përdorimi i shpeshtë i shpirtëzimeve dhe i njerëzimeve. Mund të vërehet se njerëzimet dhe shpirtëzimet e tij, shpesh me prejardhje folklorike dhe mitologjike.

Idealet e Naimit janë, në thelb në tërësinë e tyre, ideale përparimtare demokratike, që përshkohen nga një humanizëm i fuqishëm. Ndër motivet kryesore patriotike të trajtuara nga Naimi në krijimet e tij mund të përmendim: dashurinë dhe mallin për atdheun, krenarinë për të kaluarën historike të popullit, dashurinë për gjuhën, urrejtjen për armiqtë, përbuzjen për tradhëtarët etj. Ndjenjat dhe mendimet patriotikë të Naimit janë të pastra dhe të zjarra.

Ai mburret për të kaluarën e lavdishme të atdheut, ka besim në forcat e popullit dhe shpresa të ndritura për të ardhmen, hymnizon natyrën e maleve shqiptare dhe digjet nga malli për vendlindjen, godet armiqtë dhe stigmatizon tradhëtinë, i këndon trimërisë e bashkimit dhe çdo gjë shqiptare i ngjanë e bukur dhe e madhërishe.

Naim Frashëri i dha vend të dukshëm trajtimit të temës të së kaluarës historike, duke u nisur prej tezës të së prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve dhe duke u përpjekur sa herë i vjen rasti të përmendë lashtësinë e kombit dhe njerëzit e shquar që kanë dalë nga gjiri i tij. Në vjershën e gjatë moralizuesen “Parajsa” dhe prej shumë krijimeve me temë patriotike, Naimi nguli këmbë në nevojën e bashkimit i nisur nga mendimi se gjithë shqiptarët janë vëllezër.

Titujt e krijimeve me tematikë fetare janë të shumta, këtu vlen të përmendet poema “Qerbelaja”.

Kjo poemë është epike e luftërave të khalifit Ali dhe të bijve të tij kundës Mavijës dhe bijve të tij për fronin e khalifatit arab. Si poema “Istori e Skënderbeut” ashtu edhe poema “Qerbelaja” janë vepra mbi të kaluarën historike që më dukshëm se të gjitha shkrimet e tij të tjera në vargje, përfaqësojnë shprehjen e kërshërisë historike të Naim Frashërit.

Poema “Qerbelaja” përbëhet nga 25 këngë, ku vargjet janë të renditura pa ndërprerje njëra pas tjetrës. Ai zgjodhi tetërrokëshin e këngës lirike popullore, sepse ajo që më e përhapur dhe më e afërt me lexuesin. “Qerbelaja” është një poemë e gjatë që meriton vëmendjen e studiuesve, sepse hedh dritë në shumë drejtime: ajo na ndihmon të njohim plotësisht personalitetin e autorit, botëkuptimin e tij, dhe ato parime fetare që mbujtën shumicën e veprave të tij. Përveç kësaj, tani mund të themi se Qerbelaja na jep mundësinë të krahasojmë dy botë kulturore: botën kulturore që i referohet islamizmit dhe në veçanti bektashizmit, me botën kulturore që i referohet krishtërit. Qerbelaja zgjeron horizontin kulturor kombëtar dhe rreh çështje që i përkasin botës kulturore-fetare mbikombëtare dhe ndërkombëtare.

Sipas pikëpamjeve të Naim Frashërit, rrafshi gjuhësor dhe ai letrar janë në sinkroni me njëra-tjetrën. Gjuha është mjete i komunikimit ndërmjet njerëzve, sepse po të mos çmohej vetëm, ashtu siç diti ta bënte Naimi, ajo do të mbetej e panjohur në etnitetin e saj dhe që gjuha është e rëndësishme në botëkuptimin e tij.

Qëndrimi i tij ndaj fjalëve të huaja në gjuhën kombëtare sikur e dëshmon bindjen se shkalla e mëvetësisë kombëtare të një populli më së miri mund të shihet e të njihet përmes shkallës së zhvillimit e të përsosjes në të cilën flet dhe shkruan ai. Gjuha e përzier me fjalë të huaja sqaron fatin e historinë, gjendjen dhe kulturën e një vendi apo të një kombi.

Si përfudnim në lidhje me analizën e veprës letrare të letërsisë kombëtare të kapet totaliteti i fenomenit letrar, domosdo shpie te takimi me treshin famoz: *autori-vepra-lexuesi*, të cilin nuk mund ta përjashtojë kurrfarë trajtimi më serioz i letërsisë. Trajtimi i përbashkët i këtij treshi e jep totalitetin e letërsisë kurse forcimi apo mënjanimi i cilitdo prej tyre e bën të ngushtuar trajtimin e saj. Në studimet tona në të shkuarën analiza është përqendruar në autorin, nga shkak i thjeshtë se ëhstë mbiçmuar ideja në veprën letrare kurse vetë shkrimtarët ishin intelektualët e parë për të mos thënë edhe figurat më të çmuara në historinë e kombit.

Kështu që çfarëdo shkrimi me pretendime historike, shoqërore, po se po edhe letrare i del para problem i madh i ndarjes, i dallimit të punës së apostullit nga puna e krijuesit, problem që e hetonte që moti Çabej në shembullin e Naim Frashërit. I njëjti problem apo i ngjashëm del edhe kur trajtohet veçanërisht funksioni shoqëror i letërsisë, kur ky funksion tenton të ngrihet në kriter të vlerës letrare, madje edhe në një vlerësim retrospektiv të letërsisë dhe merret me veprat e të shkuarës. Ky problem mund të shihet më saktësisht dhe të silllet në masën e vet nëse ky përmbahet në vetë strukturën e saj të brendshme të veprës letrare, e cila ndahet në vetë strukturën e saj të brendshme dhe në kuptimin e saj të përgjithshëm.

Naim Frashëri ngriti vlerat e fjalës shqipe në rrafshin e gjuhës së poezisë e të artit të vërtetë, duke vënë në bazë të gjuhës së poezisë gjuhën popullore dhe se forca e fjalës në poemën e Naimit nuk qëndron në kuptimin e drejtpërdrejtë të saj, por në ato marrëdhënie asociative ose tek aureola emocionale që u jep atyre konteksti në të cilin përdoren. Prej këtij kuptohet që studimi i ligjërit mund të përfshijë dy rrafshë: rrafshin gjuhësor dhe atë letrar. Lidhja e ngushtë e të dy rrafshëve do të ishte e frytshme dhe kjo kërkon si dorën e gjuhëtarit, ashtu edhe mendjen e dorën e studiuesit e të kritikut letrar. E kemi pohuar më parë që ligjërimi poetik i Naimit mund të vështrohet në rrafshin gjuhësor dhe në rrafshin stilistik.

BIBLIOGRAFIA:

Bulo, Jorgo, *Naim Frashëri dhe zhvillimi tipologjik i poezisë shqipe*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.

Bulo, Jorgo, *Naim Frashëri dhe zhvillimi tipologjik i poezisë shqipe*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.

Bulo, Jorgo, *Tipologjia e lirikës së Naimit Frashërit*, Tiranë, 1999.

Costante Fortino, Italo, *Naim Frashëri: kufij letrarë dhe pikëpamje krahasuese*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.

Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006.

Frashëri, Naim, *Bagëti e bujqësija*, Bukuresht, 1886.

Frashëri, Naim, *Vepra 4*, Kënga XXII, Rilindja, Prishtinë.

Hamiti, Sabri, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003.

Hamiti, Sabri, *Studime letrare*, Prishtinë, 2003.

Qosja, Rexhep, *Naim Frashëri dhe gjendja shpirtërore e popullit shqiptar sot*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2000.

Qosja, Rexhep, *Panteoni i rralluar*, vepra 1, vëllimi i parë, Insituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.

Thomai, Jani, *Vështrim mbi leksikon e ligjërimet poetik të Naim Frashërit*, në revistën: "Stili 97", Shkup, 1998.

Thomani, Jani, *Për një tipologji leksiko-semantike të ligjërimet naimian*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.

Xhiku, Ali, *Naim Frashëri dhe shkollat e romantizmit shqiptar*, në revistën: "Studime filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2000.